

RELACION

PËR MIRATIMIN E PROJEKTLIGJIT “PËR PARANDALIMIN DHE MBROJTJEN NDAJ DHUNËS NDAJ GRAVE DHE DHUNËS NË FAMILJE”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji “Për parandalimin dhe mbrojtjen ndaj dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”, që propozohet nga Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), është një akt politik i qeverisë shqiptare që synon parandalimin dhe reduktimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave në veprimtarinë publike dhe private dhe dhunës në familje.

Qëllim i këtij Projektligji është mbrojtja e viktimave të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje përmes masave të përshtatshme ligjore, masave të tjera të nevojshme dhe politikave të integruara dhe gjithëpërfshirëse. Vëmendje e veçantë i kushtohet grupeve të cënueshme.

Sipas këtij Projektligji dhe kuadrit ligjor në fuqi, parashikohet shqyrtimi pa vonesë dhe përmes mjeteve juridike civile dhe administrative, i të gjitha rasteve të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, të cilat shkelin integritetin fizik, psikologjik, social, ekonomik, seksual, të viktimave të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Zbatimi i masave ligjore dhe administrative për parandalimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, parashikohet ndaj çdo personi, përfshirë subjektet publike dhe private.

Për parandalimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave në gjithë sektorët e veprimtarisë dhe dhunës në familje, parashikohet hartimi, miratimi dhe zbatimi i një politike kombëtare gjithëpërfshirëse, si dhe masa të koordinuara për mbrojtjen dhe ndihmën me në qendër viktimën.

Projektligji synon krijimin e një rrjeti të koordinuar institucionesh përgjegjëse për mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave, parandalimin e të gjitha formave të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, si dhe lehtësimin e pasojave duke përcaktuar edhe funksionimin e strukturave të organeve përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor. Bashkëpunimi efektiv ndër-institucional ndërmjet autoriteteve përgjegjëse, synon një qasje të integruar për të parandalimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.

Një tjetër objektiv që Projektligji synon të arrijë është forcimi i sistemit gjyqësor, me qëllim marrjen e masave të menjëhershme të mbrojtjes ndaj dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje si dhe garantimin për viktimat e dhunës të aksesit të shpejtë, falas dhe të thjeshtuar pranë gjykatave ose organeve të tjera kompetente.

Projektligji hartohet në vazhdimësinë e politikave të ndërmarra nga shteti shqiptar për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare, duke e zgjeruar fushën e zbatimit për të gjitha format e dhunës ndaj grave (jo vetëm dhunën në marrëdhënie familjare), pa përjashtim të mjedisit ku kryhen apo mjetit përmes të cilit realizohen, duke siguruar mbrojtjen nga dhuna ndaj grave në

sferën publike dhe private, përfshirë kontekstet e familjes, të komunitetit, në hapësirat publike, në vendin e punës dhe praktikave profesionale, gjatë kohës së lirë, në politikë, në veprimtaritë sportive, shërbimeve shëndetësore, mjediseve arsimore dhe argëtuese, përfshirë mjediset e ndërmjetësuara nga teknologjia, siç janë dhuna e lehtësuar nga teknologjia dhe në mjedise të tjera digjitale.

Projektligji zbatohet për të gjitha viktimat e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, në proceset administrative dhe civile pavarësisht gjinisë, duke përfshirë edhe viktimat e veprave penale të parashikuara në Kodin Penal; viktimat në kohë paqeje, në situata konflikti të armatosur dhe në situata emergjente.

Projektligji i propozuar “Për parandalimin dhe mbrojtjen ndaj dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”, do të kontribuojë për realizimin e objektivave të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030 dhe planit të saj të veprimit (VKM nr. 400, datë 30.06.2021), Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2022–2030 (VKM Nr. 88, datë 22.2.2023), si dhe lidhet me strategji të tjera ndërsektoriale dhe plane veprimi, si: Strategjia Kombëtare e Sigurisë Kibernetike 2020-2025 (VKM nr. 1084/2020), Axxhenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, si dhe aktet e hartuara politike për përparimin e procesit të integrimit evropian të vendit.

Projektligji zëvendëson Ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” (*Ndryshuar me ligjin nr. 9914, datë 12.5.2008, nr. 10 329, datë 30.09.2010, nr. 47/2018, datë 23.7.2018, nr. 125/2020, datë 15.10.2020*).

Në mbështetje të synimit të përgjithshëm, qëllimet kryesore të këtij projektligji janë:

- transformim rrënjësor, duke kaluar nga një ligj i fokusuar ngushtë te dhuna në familje, në një kuadër gjithëpërfshirës që adreson të gjitha format e dhunës ndaj grave ku mund të listohen dhuna fizike, ekonomike, psikologjike dhe seksuale, ngacmimi dhe ngacmimi seksual në marrëdhëniet e punës, dhuna e lehtësuar nga teknologjia, dhuna ndaj grave në politikë si dhe dhuna në familje;
- mbrojtje përtej dhunës në familje, me fokus grupet e cënueshme;
- integrim i politikave kombëtare dhe qasje gjithëpërfshirëse me në qendër viktimën;
- përafrimi me Direktivën e BE-së 2024/1385, Konventën e Stambollit, Konventën nr.190 të Organizatës Ndërkombëtare të Punës;
- duke zgjeruar përkufizimet, forcuar parimet themelore dhe rritur përgjegjësinë e shtetit dhe aktorëve private.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektligji hartohet në mbështetje të neneve 18 pika 1 dhe 2, 53 pika 2, 54, 81 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe është në përputhje me Programin Politik të Qeverisë shqiptare, si dhe është i planifikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të

Projektakteve për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për vitin 2025, katërmujori i tretë.

Projektligji është në përputhje me vizionin e Qeverisë shqiptare dhe në përmbushje të prioritetëve të shpallura në Programin Politik Qeverisë 2021-2025,¹ dhe posaçërisht me pjesën “Familja” në të cilën parashikohet angazhimi për politika që rrisin “. . .strehimin e . . . grave e vajzave, duke rritur njëkohësisht në sasi e cilësi të gjitha shërbimet e shtetit për familjet”,² pjesën “Strehimi” në të cilën parashikohet angazhimi për rritjen e “...numrin e grave kryefamiljare, ... si përfitues prioritarë të programit social për strehimin...”,³ pjesën “Kujdesi për të moshuarit dhe qytetarët më në nevojë” ku parashikohet rritja me “..10% përfshirjen e grave kryefamiljare në skemën e ndihmës ekonomike” si dhe zgjerimi i “.. qendrave dhe shërbimeve të reja në territor për ... gratë në nevojë në të gjitha bashkitë e vendit si dhe do të mbështetet krijimi i 11 ndërmarrjeve sociale me qëllim mbështetjen e grave dhe vajzave..”⁴

Projektligji lidhet drejtëpërdrejtë me masat për përfshirjen sociale në zbatim të objektivave dhe masave të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2022-2030 të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 88, datë 22.02.2023 *“Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030”*, i cili thekson vizionin e *“një shoqërie e cila vlerëson barazinë dhe drejtësinë gjinore si kushte të domosdoshme drejt zhvillimit të qëndrueshëm social, ekonomik e politik të vendit, fuqizon të gjithë individët për të gezuar të drejta dhe mundësi të barabarta në të gjitha fushat e jetës, nuk lejon që askush të mbetet pas, si dhe mbështetet në parimin e tolerancës zero kundër praktikave të dëmshme, dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, duke ndëshkuar dhunuesit dhe duke mbrojtur, rehabilituar e riintegruar personat e dhunuar”* dhe që synon *“zvogëlimin e të gjitha formave të praktikave të dëmshme, dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje”*⁵.

Gjithashtu, projektligji është në përputhje me Piketat hapëse të Grupkapitullit të I-rë “Themelorët”, të miratuara me vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 736, datë 13.12.2023 “Për miratimin e Udhërrëfyesit për Shtetin e së Drejtës”, pikën III.K “Barazia gjinore dhe te drejtat e grave”. Në këtë pikë adresohet çështja e përafrimit të kuadrit ligjor për barazinë gjinore në përputhje me *acquis* të BE- së dhe rritja e kapaciteteve institucionale, nëpërmjet ndryshimeve në Ligjin për Dhunën në Familje për të siguruar harmonizim të plotë me Konventën e Stambollit, deri në vitin 2030.⁶

Ky projektligji është në harmoni me Strategjinë e Barazisë Gjinore 2020-2025⁷ të Bashkimit Evropian, të specifikuar më tej në Planin e Veprimit për Barazinë Gjinore (GAP III) 2021-2025, publikuar në 25 nëntor 2020, si dhe është në linjë me Marrëveshjen e Stabilizimit Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e Shteteve të tyre anëtare (MSA), neni 99 “Bashkëpunimi Social”.

¹ https://kryeministria.al/wp-content/uploads/2021/10/Programi_Qeverises_2021-2025.pdf.

² Po aty, fq. 28.

³ Po aty, fq. 29.

⁴ Po aty, fq. 33.

⁵ <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2023/02/22/88/59519cb2-2180-4e7e-9d91-68545a68e008>, faqe 130

⁶ <https://ëëë.kryeministria.al/ëp-content/uploads/2024/11/Udh%C3%ABr%C3%ABfyesi-p%C3%ABr-shtetin-e-s%C3%AB-drejt%C3%ABs.pdf> , faqe 4

⁷ <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52020DC0152&from=EN>

Projektligji pasqyron edhe lidhjen e drejtpërdrejtë me plotësimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, e në mënyrë specifike me: Objektivin 3 për shëndetin e grave; Objektivin 4 për arsimimin e grave; Objektivin 5 për barazinë gjinore dhe kundër praktikave të dëmshme, si dhe Objektivin 16 për të luftuar dhunën ndaj grave dhe abuzimin e fëmijëve. Në kuadër të Axfordës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, Shqipëria është angazhuar për të eliminuar martesat e hershme dhe me detyrim, për të arritur barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave dhe vajzave, në një mjedis të qëndrueshëm.

Projektligji lidhet edhe me strategjitë ndërsektoriale në fushën e sigurisë kibernetike dhe mbrojtjes kibernetike, në drejtim të përmirësimit të masave parandaluese dhe mbrojtëse në lidhje me krimin kibernetik dhe përmbytjet e paligjshme në internet, sigurinë në internet dhe mbrojtjen e fëmijëve në internet, të përcaktuara në Strategjinë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike 2020-2025 dhe Planin e Veprimit të saj.

Projektligji është në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe plani i saj i veprimit 2021-2030, të miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 400, datë 30.6.2021, e cila thekson përparësinë dhe vëmendjen e veçantë që qeveria e Shqipërisë i kushton zvogëlimit të dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, duke e konsideruar adresimin e duhur të tyre si kushte drejt një zhvillimi të qëndrueshëm. Projektligji lidhet me parimet kryesore që udhëheqin SKBGJ 2021–2030, e më specifikisht me tolerancën zero kundrejt dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, me qëllim mbrojtjen e jetës, dinjitetit dhe integritetit njerëzor, si një parakusht për zhvillimin e një vendi, pasi çdo formë dhune është sulm mbi dinjitetin njerëzor dhe shkelje e të drejtave të njeriut, ndaj nuk duhet të tolerohet.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Parandalimi, reduktimi dhe mbrojtja nga të gjitha format e dhunës ndaj grave në veprimtarinë publike dhe private dhe dhunës në familje, është një ndër prioritet dhe drejtimet kryesore politike për zhvillimin e vendit. Në kuadër të çeljes së negociatave me Bashkimin Europian dhe nevojës për përafrimin sa më të plotë të legjislacionit shqiptar me aktet e mësipërme të BE-së, është e nevojshme të bëhen rregullimet e duhura ligjore që mundësojnë arritjen *de facto* të parandalimit, reduktimit, mbrojtjes nga të gjitha format të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje në shoqërinë shqiptare, si kusht drejt një zhvillimi të qëndrueshëm.

Aktualisht me Ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” (*Ndryshuar me ligjin nr. 9914, datë 12.05.2008, nr. 10 329, datë 30.09.2010, nr. 47/2018, datë 23.07.2018, nr. 125/2020, datë 15.10.2020*), është rregulluar dhuna në marrëdhëniet familjare por nuk janë parashikuar forma të tjera të dhunës ndaj grave, si në sferën private ashtu edhe në atë publike. Ky ligj rregullon çështjet themelore të dhunës në familje si dhe masat e mbrojtjes ndaj saj. Që kur ka hyrë në fuqi, ky ligj është ndryshuar dhe amenduar katër herë, për të garantuar mbrojtjen e duhur ndaj kësaj forme dhune, por nga një sërë vlerësimesh të organizmave të brendshëm dhe ndërkombëtarë, është vënë në pah nevoja për ndryshime ligjore me qëllim arritjen e mbrojtjes gjithëpërfshirëse nga të gjitha format e dhunës.

Çështjet e identifikuar si të nevojshme për rregullime ligjore janë të konsiderueshme dhe vënë në pah nevojën për një ligj të ri, në përputhje të plotë me standardet e Konventës së Organizatës së Kombeve të Bashkuara “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave”

(Konventa e Stambollit); Konventës së Këshillit të Evropës “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje” (CEDAW); Konventës nr. 190 “Mbi dhunën dhe ngacmimin në botën e punës” të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (Konventa 190 ILO); Direktivës (BE) 2024/1385 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 14 maj 2024 “Për luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”, për trajtimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave në mënyrë gjithëpërfshirëse.

Legjilacioni i brendshëm duhet të plotësohet për adresimin e plotë dhe gjithëpërfshirës të të gjitha formave të dhunës ndaj grave, në fushën civile dhe penale (sipas parashikimeve që bën edhe Konventa e Stambollit). Prandaj ky projektligj do të ndikonte në parandalimin dhe mbrojtjen nga forma të tjera të dhunës që nuk janë vlerësuar më parë.

Legjislacioni aktual e vendos theksin më së shumti tek “dhuna në familje” por kjo nuk është e mjaftueshme për mbrojtjen nga të gjitha format e dhunës ndaj grave. Forma të tjera të dhunës ndaj grave, ndonëse të parashikuara si vepra penale, nuk kanë marrë vëmendjen e duhur në lidhje me parandalimin dhe masat e mbrojtjes civile/administrative, pavarësisht nevojës për adresimin e tyre. Mjetet ligjore në fuqi, nuk janë të mjaftueshme me qëllim që autoritetet përgjegjëse të përmbushin detyrimet për të marrë masa të nevojshme parandaluese ose mbrojtëse brenda objektit të kompetencave të tyre.

Në dhënien e shërbimeve emergjente dhe atyre afatmesme dhe afatgjata, për viktimat e dhunës ndaj grave, duhet të ketë një reagim të duhur në plotësimin e boshllëqeve legjislative dhe atyre institucionale, për t’iu përgjigjur nevojave të të mbijetuarave të dhunës në përputhje me standardet ndërkombëtare, e konkretisht plotësimit të legjislacionit duke përfshirë dhunën dhe ngacmimin seksual, ngacmimin në mjedisin e punës, dhunën e lehtësuar nga teknologjia etj.

Në lidhje me masat që parashikohen ndaj punonjësve, në rastet kur ata nuk përmbushin detyrimet kundrejt viktimave të dhunës, legjislacioni në fuqi vlerësohet se është i plotë dhe shterues. Në këtë drejtim, nuk vlerësohet i nevojshëm rishikimi i legjislacionit, por nxitja më tej e përmbushjes së detyrimeve të parashikuara në kuadrin ligjor ekzistues, si për masat parandaluese ashtu edhe për masat mbrojtëse, si dhe rritje e numrit të punonjësve që ushtrojnë këto detyra.

Bazuar në sa më sipër, ndryshimet ligjore janë të qenësishme dhe drejtojnë ecurinë në hartimin e një ligji të ri për parandalimin dhe mbrojtjen ndaj dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.

Si rrjedhojë, çmohet i nevojshëm miratimi i një ligji të ri për parandalimin dhe mbrojtjen ndaj dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje dhe në vijim përgatitja e paketës së plotë të akteve nënligjore.

IV.VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji propozohet nga MSHMS në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar, si dhe bazohet në parimet e sanksionuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Gjithashtu, projektligji është në harmoni me legjislacionin ndërkombëtar përkatës, konkretisht me:

- Konventën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave”;
- Konventën e Këshillit të Evropës, “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”;
- Konventën nr. 190 “Mbi dhunën dhe ngacmimin në botën e punës” të Organizatës Ndërkombëtare të Punës;
- Direktivën (BE) 2024/1385 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 14 maj 2024 “Për luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”;
- Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian: Kapitulli I (nenet 3-5), Kapitulli II (nenet 6-9), Kapitulli III (neni 21, nenet 23-26), Kapitulli IV (nenet 35-36), Kapitulli VI (neni 47);
- akte të tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

V.VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Projektligji është përafëruar tërësisht me:

- Direktivën (BE) 2024/1385 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 14 maj 2024 “Për luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”.

Përsa i përket parashikimeve civile-administrative që i përkasin këtij Projektligji, ndërsa për parashikime të tjera të natyrës penale do të duhet të bëhet përafrimi në dispozitat e Kodit Penal.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji sjell risi në disa aspekte, të lidhura me:

- objektin dhe fushën e zbatimit;
- saktësime të parimeve;
- përkufizime: shtesa dhe saktësime;
- format e dhunës;
- subjektet dhe raportimi;
- mbrojtja e viktimave;
- masat: shtohen dhe përforcohen;
- parandalimi dhe ndërhyrja;
- përforsim të organeve/institucioneve përgjegjëse për masat parandaluese dhe mbrojtëse, duke përfshirë qartazi edhe subjektet private në tërësinë e subjekteve ndaj të cilëve shtohen masat;
- autoritet, koordinimi dhe bashkëpunimi;
- shtohen masat ndëshkuese administrative;
- shtohen masat e lidhura me hartimin, zbatimin dhe raportimin;
- vendoset afati i miratimit të akteve nënligjore;
- etj.

Projektligji është i përbërë nga **60 nene gjithsej**, të organizuara në **9 Krerë**, si vijon:

Risite kryesore të Kreut I – Dispozitat e Përgjithshme

Kreu I i projektligjit sjell një transformim rrënjësor të ligjit aktual, duke kaluar nga një kuadër i fokusuar ngushtë te dhuna në familje në një ligj gjithëpërfshirës për të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Ai përafron plotësisht legjislacionin shqiptar me standardet e BE-së (Direktiva e BE-së 2024/1385 e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e datës 14 maj 2024 “Për luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”) dhe KE-së (Konventa e Këshillit të Evropës, “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”). Projektligji zgjeron përkufizimet, prezanton mekanizma të rinj, forcon parimet themelore dhe rrit përgjegjësinë e shtetit dhe aktorëve të tjerë në lidhje me mbrojtjen dhe parandalimin.

Qëllimi i ligjit (Neni 1): Projektligji i ri parashikon reduktim, mbrojtje dhe masa parandaluese përtej “dhunës në familje”, duke përfshirë në mënyrë të qartë të gjitha format e dhunës ndaj grave në jetën publike e private dhe dhunës në familje. Në aspekt të ndërthurjes me instrumentet ndërkombëtare, është bërë një përafrim i drejtpërdrejtë me Konventën e Stambollit dhe Direktivën e BE-së. Ai ka një fokus të zgjeruar te grupet e cënueshme.

Objekti i ligjit (Neni 2): Projektligji parashikon krijimin e një rrjeti të koordinuar institucional, për një bashkëpunim të plotë ndërmjet autoriteteve qendrore, vendore dhe aktorëve privatë. Forcimi i mekanizmave gjyqësorë është një ndër qëllimet e projektligjit, ku parashikohet marrja e masave të menjëhershme mbrojtëse përmes gjykatave. Qasja më e lehtë në drejtësi garantohet nëpërmjet aksesit falas, të shpejtë dhe të thjeshtuar për viktimat.

Fusha e zbatimit (Neni 3): Projektligji e shtrin fushën e zbatimit përtej dhunës në marrëdhëniet familjare, duke mbuluar dhunën në mjediset publike, në vendin e punës, në arsim, në shëndetësi, në sport, në politikë, në hapësira digjitale dhe internet (përfshirë dhunën e lehtësuar nga teknologjia). Përfshirja gjithëpërfshirëse e viktimave garantohet pasi mbrojtja ofrohet për çdo viktimitë të dhunës ndaj grave, pavarësisht gjinisë dhe në proceset administrative dhe civile. Risi është garantimi i mbrojtjes edhe dhe zbatimi në kohë paqeje, në situata konflikti të armatosur, në situata emergjente.

Parimet e përgjithshme (Neni 4): Projektligji bazohet në disa parime të përgjithshme, të ndërtuara mbi standardet e BE-së dhe Konventës së Stambollit. Ndër më kryesoret janë:

- Qasja me në qendër viktimën dhe shmangia e viktimizimit dytësor;
- Parimi i respektimit të konfidencialitetit dhe privatësisë së viktimës;
- Parimi i mos-justifikimit të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje;
- Parimi i aksesit në drejtësi dhe shërbime;
- Parimi i ndalimit të ndërmjetësimit në çështjet e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.

Projektligji është përafruar më gjerë me aktet ndërkombëtare, sepse përveç Konventës së Stambollit, referohen edhe Konventa CEDAW, Konventa ILO 190, si dhe instrumente të tjera të ratifikuara nga RSH.

Risite kryesore të Kreut II – Përkufizimet dhe format e dhunës

Kreu II parashikon zgjerimin dhe detajimin e formave klasike të dhunës si ajo fizike, psikologjike, ekonomike dhe seksuale, duke përfshirë gjithashtu format të dhunës ndaj grave të përcaktuara nga Konventa e Stambollit. Ligji sjell një kornizë të re për dhunën e lehtësuar nga teknologjia, duke adresuar ngacmimin, përndjekjen, keqpërdorimin e imazheve intime dhe gjuhën e urrejtjes online, si dhe vendos masa civile-administrative në këtë mjedis me juridiksion të zgjeruar dhe bashkëpunim ndërkombëtar.

Zgjerimi i kategorive të dhunës klasike Dhuna fizike, psikologjike, ekonomike dhe seksuale tashmë janë të detajuara më qartë, me elemente të reja **Parashikimi i formave të reja të dhunës ndaj grave bazuar në Konventën e Stambollit:**

Përkufizimet (neni 5): Zgjerimi dhe detajimi i termave është përafruar me aktet ndërkombëtare, duke qenë se përfshihen nocione të reja si: *dhuna ndaj grave, provë elektronike ose digjitale*, Qasja gjithëpërfshirëse për viktimën është theksuar duke konsideruar viktimë çdo person (jo vetëm gratë) edhe fëmijët dëshmitarë të dhunës.

Projekt ligji parashikon dhe përkufizon për herë të parë të gjitha format e dhunës ndaj grave si: Dhuna fizike (neni 6), Dhuna psikologjike (neni 7), Dhuna ekonomike (neni 8), Dhuna seksuale dhe ngacmimi seksual (neni 9), Dhuna e lehtësuar nga teknologjia (neni 10), Dhuna ndaj grave në politikë (neni 11).

Risite kryesore të Kreut III– Subjektet dhe raportimi

Kreu III sjell ndryshime të rëndësishme krahasuar me ligjin aktual, duke zgjeruar kategoritë e mbrojtura përfshirë edhe subjektet e huaja, azilkërkesit, si dhe duke krijuar mekanizma të rinj raportimi si platforma online, struktura të brendshme në institucione dhe përfshirja e shoqërisë civile. Ai vendos detyrime të qarta për profesionistët dhe autoritetet lidhur me raportimin dhe ofrimin e mbrojtjes së menjëhershme, njëkohësisht forcon të drejtat e fëmijëve si raportues dhe viktima të dhunës.

Subjektet e mbrojtura (neni 12): Kategoritë e subjekteve të mbrojtura zgjerohen qartazi dhe përfshijnë jo vetëm shtetasit shqiptarë, shtetasit e huaj, personat pa shtetësi, por edhe azilkërkesit, etj. Garancitë shtesë parashikojnë që të gjitha format e dhunës ndaj grave, në sektorin publik dhe privat (jo vetëm dhuna në familje) janë të mbuluara nga ky projektligj.

Raportimi i dhunës (neni 13): Diversifikimi i kanaleve të raportimit parashikon që raportimi mund të realizohet jo vetëm në Polici, në njësitë e vetqeverisjes vendore, por edhe në qendrat shëndetësore, organizatat e shoqërisë civile, qendrat e specializuara dhe institucionet e të drejtave të njeriut. Raportimi brenda subjekteve parashikon që viktima e një nga formave të dhunës ndaj grave dhe (p.sh. në vendin e punës) mund të drejtohet fillimisht te mekanizmat e brendshëm të institucionit privat/publik. Për qasje të menjëhershme në gjykatë parashikohet qartë se viktima mund t'i drejtohet njëkohësisht gjykatës për masa mbrojtëse. Projektligji sjell risi digjitale duke parashikuar raportim online ose përmes teknologjive të informacionit, duke e bërë raportimin më të aksesueshëm dhe më të sigurt.

Ky nen parashikon të gjitha llojet e subjekteve që mund të raportojnë rastet e dhunës, të tilla si: **Raportimi nga subjekte të tjera.** Raportimi i dhunës është i hapur nga çdo person, pra çdo individ, punonjës publik apo privat, organizatë, mund të raportojë rastet e dhunës. Nxitja për raportim proaktiv parashikohet për autoritetet të cilat kanë detyrimin të inkurajojnë raportimin edhe në rastet e rrezikut të mundshëm të dhunës. Garanci e re në kuadër të raportimit është mbrojtja e anonimitetit dhe sigurisë së raportuesit, veçanërisht dëshmitarëve. **Raportimi nga fëmijët/të miturit** Projektligji parashikon garanci të posaçme për fëmijët pasi raportimi i një fëmije nuk varet nga pëlqimi i prindit/kujdestarit nëse ky i fundit është autor i dhunës. Raportimi kryhet sipas procedurave miqësore për fëmijët, të cilat duhet të jenë të sigurta, konfidenciale, me gjuhë të përshtatshme për moshën dhe nga profesionistë të trajnuar.

Projektligji garanton parandalimin e viktimizimit dytësor duke parashikuar se fëmija duhet të pyetet vetëm një herë. Këto janë standarde të reja që nuk gjenden në ligjin aktual dhe janë në përputhje me Direktivën e BE-së dhe Konventën e Stambollit. **Raportimi nga autoritetet dhe profesionistët** Detyrim i qartë për raportim është parashikuar për çdo profesionist që duhet të raportojë pa vonesë kur ka arsye të besojë se ka ndodhur ose rrezikohet të ndodhë dhunë. Identifikimi i hershëm i nevojave kryhet nga profesionisti ose autoriteti që merr dijeni, i cili ka detyrim të bëjë vlerësimin e parë të nevojave të viktimës. Autoritetet mund të referojnë menjëherë fëmijët te shërbimet mbështetëse edhe pa autorizimin e prindit/ kujdestarit. Parimi i proporcionalitetit mbahet në konsideratë në rastin e raportimit dhe masave që merren, në mënyrë që të shmanget viktimizimi dytësor.

Mos kufizimi i raportimit nga profesionistët (neni 14) parashikohet si një nga risitë e ligjit. Rregullat e konfidencialitetit të lidhura me veprimtarinë e autoriteteve përgjegjëse, nuk zbatohen në rastet kur këto përbëjnë një pengesë për profesionistët përfshirë ata të kujdesit shëndetësor për të raportuar rastin ose kur kanë arsye për të besuar se ekziston një rrezik i menjëhershëm për dëmtimin e viktimës.

Risitë kryesore të Kreut IV – Mbrojtja e Viktimave

Nga një ligj që më parë e kufizonte mbrojtjen kryesisht te urdhrat e mbrojtjes dhe shërbimet bazike ndaj viktimës, drafti i ri shndërrohet në një paketë gjithëpërfshirëse që rrit aksesin e viktimave në shërbime, zgjeron kategoritë e tyre dhe adreson nevojat specifike, standardizimin e përdorimit të provave digjitale dhe garantimin e mbështetjes së posaçme për fëmijët, personat me aftësi të kufizuara, viktimat e formave të ndryshme të dhunës ndaj grave dhe shtetasit e huaj.

Vlerësimi individual për mbrojtjen dhe mbështetjen e viktimave (neni 15): për herë të parë parashikohet vlerësim individual dhe i personalizuar i viktimës, i lidhur me nevojat mbështetëse dhe mbrojtëse. Mundësia e referimit parashikohet kur viktimë është i mitur edhe pa pëlqimin e prindit/kujdestarit si dhe nga persona të tretë, jo vetëm nga viktimë (një hap i madh në drejtim të identifikimit të hershëm). Parashikohet akt nënligjor për treguesit, metodologjinë dhe intervalet e vlerësimeve periodike, për standardizim të procesit. Treguesit e vlerësimit individual varësisht formës së dhunës së ushtruar dhe me qëllim për mbrojtjen dhe mbështetjen e viktimave, intervalet e vlerësimit periodik dhe të kohëzgjatjes së shërbimeve, metodikat dhe procedurat e ndjekura për vlerësimin individual dhe të transmetimit të të dhënave sensitive, aktorët përgjegjës të mekanizmit kombëtar të referimit dhe roli specifik i tyre përcaktohet me Udhëzim të Ministrit të Çështjeve të Barazisë gjinore dhe Çështjeve sociale. **Shërbimet mbështetëse të përgjithshme dhe të specializuara (neni 16):** nëse shërbimet e mbështetjes së specializuar nuk ofrohen si pjesë e integruar e shërbimeve të përgjithshme të mbështetjes për viktimat, shërbimet e përgjithshme dhe ato të specializuara koordinohen. Mbështetja e përgjithshme ofrohet për të gjitha viktimat e dhunës sipas këtij ligji nga autoritetet në nivel vendor përfshirë Mekanizmin e Koordinuar të Referimit dhe organizatave të shoqërisë civile dhe përfshin: informim dhe mbështetje për çdo raportim përfshirë atë për ndihmën ligjore falas; këshillim ligjor, psikologjik dhe psikosocial falas; shërbime mjekësore dhe ekzaminime mjeko-ligjore; shërbime të menjëhershme strehimi dhe ndihmë ekonomike për viktimat e dhunës në familje për një periudhë të paktën 30 ditore, si pjesë e detyrimeve të tyre për mbrojtje sociale, integrim social-ekonomik, ndihmë dhe mbështetje financiare, ofrimin e kujdesit për fëmijët, asistencë për punësim, arsimim dhe trajnimin. Mbështetja e specializuar ofrohet si risi për viktimat e dhunës seksuale përfshirë viktimat e dhunës dhe ngacmimit në punë.

Mbështetja e përgjithshme dhe e specializuar ofrohet falas, nga profesionistë të trajnuar, mundësisht në të njëjtin mjedis dhe në mënyrë të personalizuar e të përshtatura me nevojat e viktimave e në një gjuhë që viktimat e kuptojnë duke adresuar në mënyrë gjithëpërfshirëse nevojat e shumta të viktimave.

Kategoritë e shërbimeve mbështetëse të përgjithshme dhe ato të specializuara, planet e integritetit, llojet dhe shtrirja e tyre dhe aspektet financiare, aksesin dhe disponueshmërinë e tyre, përcaktohen me udhëzim të Ministrit që mbulon çështjet sociale dhe të barazisë gjinore.

Programet e rehabilitimit (neni 17): parashikon rehabilitimin e viktimave dhe të dhunuesve, nëpërmjet programeve që synojnë ndërhyrjet e hershme parandaluese në komunitet; mbështetjen psiko-sociale dhe rehabilitimin e viktimave; trajtim psiko-social/mjekësor për dhunuesit për të ulur rrezikun e përsëritjes dhe ndryshimin e modeleve të dhunshme të sjelljes, me synim parandalimin e dhunës së mëtejshme. Programet për viktimën dhe dhunuesin zbatohen vullnetarisht ose të referuara nga Koordinatori vendor dhe gjykatat. Mos-pjesëmarrja në një program të urdhëruar nga gjykata sjell pasoja penale për dhunuesin dhe konsiderohet shkelje e vendimit të gjykatës.

Kriteret minimale, shpërndarja e shërbimeve, licencimi, monitorimi, financimi dhe kufijtë e pjesëmarrjes në programet e rehabilitimit të dhunuesve, përfshirë ato të rehabilitimit të dhunuesve në institucionet penitenciare dhe në shërbimin e provës, programet e rehabilitimit të viktimave përcaktohen me udhëzim të Ministrit përgjegjës për çështjet sociale dhe çështjet e barazisë gjinore dhe Ministrit përgjegjës për çështjet e drejtësisë.

Risitë e Kreut V – Qasja në Drejtësi

Kreu V parashikon harmonizimin me Konventën e Stambollit dhe direktivat e BE-së duke vendosur standarde europiane për urdhrat dhe masat e mbrojtjes, si dhe zgjerimin e mbrojtjes, nga ajo fizike dhe ekonomike tek format digjitale dhe në politikë. Ai garanton masa dhe procedura të shpejta dhe të aksesueshme me afate 24–48 orëshe, fuqizon rolin e policisë dhe shërbimeve sociale për mbikëqyrje e raportim, si dhe siguron mbështetje urgjente për fëmijët duke i përfshirë si subjekte të drejtpërdrejta mbrojtjeje. Po ashtu, lidh rehabilitimin e dhunuesit me sistemin penal dhe mbikëqyrjen pas lirim, duke vendosur rregulla të reja për administrimin e provave për të shmangur viktimizimin dytësor. Parashikohet detyrim për pjesëmarrje në programe rehabilitimi dhe parandalimi (psikosociale, shëndet mendor, alkool, toksikologji). Vendoset njoftimi paraprak i viktimës dhe institucioneve për lirin e dhunuesit, me plan monitorimi nga policia. **Forcimi i urdhrave të mbrojtjes:** efekt i menjëhershëm dhe i pavarur nga denoncimi penal, pra viktimat mbrohen edhe pa hapur çështje penale.

Urdhrat e mbrojtjes (neni 18): sipas këtij ligji janë tre: Urdhri për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme (UMPMM) i lëshuar nga Policia e Shtetit; b) Urdhri i mbrojtjes së menjëhershme (UMM) i lëshuar nga gjykata dhe Urdhri i mbrojtjes (UM) i lëshuar nga gjykata.

Urdhrat për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme (UMPMM) që lëshohen nga Policia e Shtetit, Urdhrat e Mbrojtjes (UM) dhe Urdhrat e Menjëhershme të Mbrojtjes (UMM) që lëshohen nga Gjykata Civile, tashmë mund të emërtohen në mënyrë specifike dhe jepen sipas rasteve apo formave specifike të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, e konkretisht:

- a) UMPMM dhe/ose UMM dhe/ose UM për masat e mbrojtjes ndaj dhunës në familje;
- b) UMPMM dhe/ose UMM dhe/ose UM për masat e mbrojtjes nga dhuna e lehtësuar nga teknologjia;

- c) UPMMP dhe/ose UMM dhe/ose UM për masat mbrojtëse ndaj dhunës ndaj grave në politikë, përfshirë formën digjitale të dhunës;
- ç) UM/ UMM për masat mbrojtëse ndaj dhunës dhe ngacmimit seksual, përfshirë në punë dhe formën digjitale të dhunës.

Në **nenet 19 deri në 22** secila formë apo lloj dhune është detajuar me masat konkrete të mbrojtjes që mund të merren nga autoritetet përgjegjëse gjyqësore civile apo administrative. Për herë të parë, përfshihen masa shumë të detajuara mbrojtjeje, jo vetëm fizike por edhe digjitale, si: ndalimi i shpërndarjes së imazheve intime, përndjekjes online, gjuhës së urrejtjes, etj. Gjykata mund të urdhërojë fshirjen e përmbajtjeve online nga ofruesit e shërbimeve, administratorët e faqeve etj. Mundësohet heqja e përkohshme e përgjegjësisë prindërore ose kujdestarisë, nëse rrezikohet fëmija. Përfshihet mbështetje financiare, ushqimore dhe strehim për viktimën dhe fëmijët, duke e lidhur drejtpërdrejt me përgjegjësinë e dhunuesit. Vendoset monitorim i zbatimit të urdhrave nga shërbimet sociale.

Urdhri administrativ për heqjen e imazheve/ materialeve të dëmshme (neni 23) përbën një risi në drejtim të ndjekjes së njoftimit apo ankimit nga viktimat në rrugë administrative të heqjes së imazheve/ materialeve të dëmshme.

Juridiksioni për masat civile dhe masat administrative në mjedisin digjital (neni 24) përcakton se masat mbrojtëse administrative të parashikuara në këtë ligj (masat për dhunën digjitale, gjobat administrative) zbatohen në territorin e Republikës së Shqipërisë, ndërkohë që autoritetet përgjegjëse shqiptare (policia e shtetit, gjykatat civile dhe AKEP-i) mund të urdhërojnë heqjen, bllokimin ose kufizimin e përmbajtjes digjitale, pavarësisht vendndodhjes së serverit apo ofruesit. Risi janë masat administrative të dënimit me gjobë nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) në rast se ofruesit e shërbimit online nuk heqin ose nuk bllokojnë ose nuk fshijnë, përmbajtjen e imazheve intime të viktimës, apo llogaritë/fjalëkalimet e përdorura për përndjekje, apo llogaritë ose lidhjet elektronike të përdorura për ngacmim; etj, të cilat janë dhënë si masa mbrojtëse me vendim gjykate, dënohen me gjobë administrative nga 30 000 deri në 500 000 lekë për çdo 24 orësh vonesë. Për këto lloj masash, parashikohet që procedura, formatet e kërkesës dhe mënyra e njoftimit elektronik miratohen me vendim të përbashkët të KLGJ-së, autoritetit përgjegjës për drejtësinë dhe autoritetit për teknologjinë e informacionit. Gjithashtu masa administrative mund të jepen edhe nga Inspektorati Shtetëror i Punës, respektivisht në rastin e dhunës dhe ngacmimit në punë.

Efektet e urdhrin të mbrojtjes (neni 25): ato kanë efekt të menjëhershëm dhe nuk varen nga raportimi i dhunës nga viktimat ose nga nisja e një vlerësimi individual. Pavarësisht prej ndonjë urdhri apo vendimi tjetër të nxjerrë nga gjykata apo ndonjë institucion tjetër, urdhri i mbrojtjes që përmban masat e parashikuara në nenin 19 të këtij ligji do të nxirret me vendim gjykate për rastet e parashikuara nga ky ligj. Risi është që vendimi i gjykatës për lëshimin e UMM dhe UM, në rastet kur subjekte të përfshira janë fëmijët, duhet t'i njoftohet edhe Zyrës Vendore Arsimore përkatëse. Në urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes ose/dhe në urdhrin e mbrojtjes, gjykata mund të parashikojë masa mbrojtëse për fëmijët që kanë pësuar dhunë ose kanë qenë të pranishëm kur është ushtruar dhunë në familje. Gjykata, mund të referojë viktimat fëmijë te shërbimet mbështetëse, edhe pa pëlqimin paraprak të mbajtësit të përgjegjësisë prindërore. Gjykata, sipas vlerësimit të saj, mund të zbatojë edhe masa mbrojtëse e procedura të

parashikuara nga legjislacioni në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, derisa nuk cenohen afatet e procesit gjyqësor të parashikuara nga ky ligj.

Risitë e Kreut VI - Procedura për lëshimin e urdhrat të mbrojtjes

Kreu VI parashikon rrethanat që merren parasysh për lëshimin e urdhrave të mbrojtjes, subjektet që kanë të drejtën të kërkojnë urdhrë mbrojtje si dhe të drejtat dhe interesat e viktimave, organet kompetente për lëshimin e tyre, formën e kërkesë padisë dhe provat në procesin gjyqësor, mënyrën e lëshimit dhe gjykimin të urdhrave të mbrojtjes, të drejtën e ankimit si dhe të drejtën për të kërkuar ndryshimin, ndërprerjen dhe vashdimin e urdhrave të mbrojtjes, ekzekutimin e tyre si vendime gjyqësore, rastin e shkeljes së urdhrat të mbrojtjes dhe procedimin penal në rast të konstatimit të dhunës ndaj grave ose dhunës në familje që përbën vepër ose kundërvajtje penale. Për herë të parë, parashikohen masa specifike për dhunën në politikë dhe në vendin e punës. Urdhrrat vlejnë edhe ex parte, pa praninë e dhunuesit, për të siguruar mbrojtje të menjëhershme. Parashikohet monitorim elektronik i dhunuesit (GPS) në raste rreziku të lartë. Gjykatat dhe policia kanë afate shumë të shpejta: 24–48 orë për të vendosur mbi urdhrat. Parashikohen udhëzime procedurale të brendshme për gjyqtarët dhe policinë për të standardizuar praktikën. Për herë të parë, bëhet ndarje e qartë e provave (përfshirë provat elektronike dhe digjitale). Ndalohet kategorikisht pajtimi ose ndërmjetësimi në rastet e dhunës me bazë gjinore. Viktimat gëzojnë ndihmë juridike falas dhe përjashtim nga çdo kosto gjyqësore. Parashikohet njoftim i punëdhënësit për vendimet e mbrojtjes, për të siguruar masa praktike. Hiqet ankimi i kufizuar, pra viktimat mund të ankohen në çdo rast, jo vetëm kur masat nuk i garantojnë mbrojtje. Shkelja e urdhrat të mbrojtjes sanksionohet si vepër penale (neni 44), me detyrim për rivlerësim të rrezikut. Procedimi penal mbetet i pavarur nga urdhri i mbrojtjes (neni 45).

Subjektet që kanë të drejtën për të kërkuar urdhrin e mbrojtjes (neni 26): e kanë zgjeruar gamën e subjekteve që mund t'i drejtohen Policisë së Shtetit dhe/ose gjykatës për urdhrë mbrojtje, duke parashikuar sipas rastit: vetë viktimën; përfaqësuesin ligjor ose avokatin e viktimës; policinë / prokurorinë; prindin ose kujdestarin e fëmijës; të afërmit e fëmijës viktimë, përfaqësuesit e strukturës së mbrojtjes së fëmijës në nivel vendor, të zyrës së shërbimeve sociale pranë bashkisë ose njësisë administrative ku ka banimin e përhershëm apo të përkohshëm viktimat fëmijë, që kanë dijeni për ushtrimin e dhunës; qendrat dhe shërbimet për mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, të njohura nga autoriteti kryesor përgjegjës; personat ligjërisht përgjegjës për fëmijët; personi me të cilin viktimat ka marrëdhënie familjare; përfaqësuesit e zyrës së shërbimeve sociale pranë bashkisë ose njësisë administrative ku ka banimin e përhershëm apo të përkohshëm viktimat, që kanë dijeni për ushtrimin e dhunës; qendrat dhe shërbimet për mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, të njohura nga autoriteti kryesor përgjegjës.

Për dhunën në formën digjitale të përmendur në nenet 19 deri në 22 të këtij ligji, garantohet mundësia e raportimit dhe dorëzimit të dëshmive online ose përmes Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit të tjera të aksesueshme dhe të sigurta, pa cenuar rregullat procedurale lidhur me formalizimin e dorëzimit të dëshmive apo raportimit online.

Të drejtat dhe interesat e viktimave (neni 27): parashikon informimin e viktimave për mundësinë e kërimit të urdhërave mbrojtës dhe për mundësinë e njohjes së tyre në shtete të huaja. Ndër të drejtat kryesore janë: mbrojtja e viktimave, të familjeve të tyre dhe të dëshmitarëve, nga hakmarrja, kërcënimet dhe viktimizimi i përsëritur; informimi i viktimave, të paktën në rastet kur viktimat dhe familja mund të jetë në rrezik, kur autori i dhunës shkel urdhrin e mbrojtjes si dhe informimin e viktimës në lidhje me lirimin e autorit të veprës penale dhe kthimin e tij në banesë; informimi i viktimave për të drejtat e tyre, për shqyrtimin e kërkesës së tyre për urdhër mbrojtje, ecurinë e përgjithshme të procesit dhe rolin e tyre në to, si dhe rezultatin e çështjes së tyre; të drejtat e viktimave për t'u dëgjuar, për të siguruar prova, për të paraqitur pikëpamjet, nevojat dhe shqetësimet e tyre, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet një përfaqësuesi, si dhe marrjen e tyre në shqyrtim; miratimin e masave për të mbrojtur jetën private dhe imazhin e viktimës; marrjen e masave që kontakton ndërmjet viktimave dhe autorëve të dhunës brenda gjykatës, strukturave të policisë së shtetit e prokurorisë apo çdo institucioni tjetër, të shmanget kur është e mundur; garantimin e përkthyesit të pavarur, kur viktimat e huaja janë palë në proces ose kur sigurojnë prova; dhënien e dëshmive në sallën e gjyqit pa qenë të pranishëm ose të paktën pa praninë e autorit të dhunës, veçanërisht nëpërmjet përdorimit të teknologjive të përshtatshme të komunikimit, kur janë në dispozicion dhe në varësi të vlerësimit të rrezikut të viktimës, viktimat të pyetet nëpërmjet sistemit audio-viziv; për fëmijët viktimat dhe dëshmitarët të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, kur është e nevojshme garantohen masa të përshtatshme dhe të posaçme mbrojtjeje, duke marrë parasysh interesin më të mirë të fëmijës; për personat në varësi që konsiderohen si të rrezikuar në të njëjtën mënyrë, të njëjtat masa mbrojtjeje si ato që u ofrohen viktimave, përveç rasteve kur ka tregues që nuk kanë nevojë të veçanta për mbrojtje. Çdo masë që bazohet në supozimin e gabuar të ekzistencës së nevojave të veçanta për mbrojtje, konsiderohet joproporcionale; pyetjen e viktimës në prani të një psikologu ose punonjësi social; shqyrtimin e çështjes së dhunës në familje edhe në mungesë të viktimës duke garantuar përfaqësimin e saj me mbrojtës të zgjedhur ose mbrojtës të caktuar kryesisht nga gjykata. Autoritetet përgjegjëse kompetente informojnë viktimat për mundësinë e kërimit të urdhërave mbrojtës dhe për mundësinë e njohjes së tyre në shtete të huaja, kur kjo është e rëndësishme për sigurinë e viktimave. Autoritetet përgjegjëse për lëshimin e urdhërave të mbrojtjes nxjerrin udhëzime të brendshme ose manuale procedurale për trajtimin e rasteve që kërkojnë lëshimin ose zbatimin e urdhërave përkatës të mbrojtjes, me natyrë këshilluese dhe bazuar në praktikën më të mira, të ndjeshme ndaj gjinisë dhe rrethanave specifike të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.

Rrethana që merren parasysh në lëshimin e urdhërave të mbrojtjes (neni 28): përbën një risi në këtë kre, i lehtëson punën dhe i orienton organet përgjegjëse për lëshimin e urdhërave të mbrojtjes, në vlerësimin e duhur të disa rrethanave specifike të viktimës por edhe të dhunuesit apo të mënyrës së kryerjes së dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.

Organi kompetent për lëshimin e urdhërave mbrojtës (neni 29): në rastet e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje të mbuluara nga ky ligj, është gjykata e juridiksionit të përgjithshëm e shkallës së parë, e vendbanimit ose vendndodhjes të viktimës, ose autorit të dhunës.

Urdhri për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme (**neni 30**), Organi kompetent dhe procedura e lëshimit të Urdhrit për Masat Paraprake të Mbrojtjes së Menjëhershme (**neni 31**), Forma e kërkesë-padisë (**neni 32**), Gjykimi për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes (**neni 34**), Vendimi i gjykatës për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes (**neni 35**), Gjykimi për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes (**neni 36**), Vendimi i gjykatës për lëshimin e urdhërave të menjëhershëm të mbrojtjes (**neni 37**), Gjykimi për vërtetimin e urdhrit të menjëhershëm të

mbrojtjes (**neni 38**), Rrethanat për ndryshimin, ndërprerjen dhe vazhdimin e urdhrit të mbrojtjes (**neni 40**), Procedimi penal (**neni 43**), janë nene të ngjashëm me ligjin aktual në fuqi nga ana procedurale dhe materiale, por me disa garanci më shumë në drejtim të mbrojtjes si psh: ndalimi i çdo procedure të detyrueshme alternative të zgjidhjes së konflikteve midis viktimës dhe autorit të dhunës, duke përfshirë ndërmjetësimin dhe pajtimin, në lidhje me të gjitha format e dhunës të mbuluara nga ky ligj. Risi është dërgimi i një kopje të vendimit të UM dhe UMM punëdhënësit të dhunuesit dhe, punëdhënësit të viktimës, vetëm në rastet kur viktima e kërkon shprehimisht ose kur rreziku lidhet me ambientin e punës, si dhe zyrave përmbartimore të vendit të ekzekutimit.

Për herë të parë, përfshihen masa shumë të detajuara mbrojtjeje, jo vetëm fizike por edhe digjitale, si: ndalimi i shpërndarjes së imazheve intime, përndjekjes online, gjuhës së urrejtjes, etj. Gjykata mund të urdhërojë fshirjen e përmbajtjeve online nga ofruesit e shërbimeve, administratorët e faqeve apo moderatorët. Mundësohet heqja e përkohshme e përgjegjësisë prindërore ose kujdestarisë, nëse rrezikohet fëmija. Përfshihet mbështetje financiare, ushqimore dhe strehim për viktimën dhe fëmijët, duke e lidhur drejtpërdrejt me përgjegjësinë e dhunuesit. Vendoset monitorim i zbatimit të urdhrave nga shërbimet sociale.

Provat në procesin gjyqësor (neni 33): kanë sjellë si risi renditjen e një sërë provash të cilat mund t'i paraqiten gjykatës por pa u kufizuar vetëm në to, ku ndër të tjera përfshihen: raport mjekësor ose raport mjeko-ligjor të lëshuar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore; prova elektronike ose digjitale në rastet e dhunës digjitale, etj. Në këtë nen detajohen rastet kur gjykata pranon prova elektronike ose digjitale si dhe ruajtjen e tyre.

Ankimi (neni 39): vjen me një risi të rëndësishme pasi tashmë garantohet e drejta e ankimit si për dhunuesin ashtu edhe për viktimën, ndaj vendimeve të gjykatës për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes, vërtetimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, si dhe moslëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, duke e hequr parashikimin e mëparshëm se nuk lejohej ankimi në apel kur viktimës i ishte garantuar mbrojtja e nevojshme.

Ekzekutimi i vendimit gjyqësor (neni 41): ka saktësuar se vendimi ekzekutohet menjëherë nga shërbimi përmbartimor gjyqësor në bashkëpunim me strukturat e Policisë së Shtetit, dhe koordinatori vendor ose zyra e shërbimeve sociale të njësisë vendore ku janë me banim të përhershëm ose të përkohshëm viktima dhe personat e tjerë të përmendur në vendim, punëdhënësi si dhe cdo institucion tjetër i ngarkuar me zbatimin e tij. Me qëllim sigurimin e respektimit dhe zbatimit të urdhrave të mbrojtjes, regjistrimin e shkeljes së këtyre urdhrave dhe përmirësimin e mbikëqyrjes së autorëve, është parashikuar që duhet të konsiderohet monitorimi elektronik dhe që viktimat duhet të informohen për kapacitetet dhe kufizimet e tij.

Shkelja e urdhrit të mbrojtjes (neni 42): parashikon jo vetëm mosekzekutimin vullnetar nga palët por edhe pengimin e ekzekutimit të urdhrave të mbrojtjes nga organet zbatuese të tyre. Ndaj personave përgjegjës zbatohen dispozitat e Kodit Penal për veprime të kryera në kundërshtim me vendimin e gjykatës. Kryerja e një rishikimi të vlerësimit individual pas raportimit të një shkelje, si dhe marrja e masave shtesë mbrojtëse për shkak të shtimit të rrezikut për viktimën. Viktima ka të drejtë të informohet pa vonesë për cdo shkelje të urdhrit të mbrojtjes, kur kjo shkelje mund të ketë ndikim në sigurinë e saj.

Risite e Kreut VII- Parandalimi

Autoritetet përgjegjëse sipas këtij ligji marrin masat e nevojshme përmes trajnimit, ndërgjegjësimin, edukimit përfshirë edukimin që në moshë të hershme dhe edukimit ligjor, përmes hartimit të rregulloreve, politikave dhe çdo nisme tjetër të përshtatshme për situatën dhe sektorin, për të promovuar ndryshime në modelet sociale dhe kulturore të sjelljes së grave dhe burrave, me synim çrrënjosjen e paragjykimeve, zakoneve, traditave dhe të gjitha praktikave të tjera që bazohen në rolet e stereotipizuara për burrat dhe gratë.

Në kuadrin e detyrimeve të përgjithshme ligji liston **ndërgjegjësimin dhe edukimin publik (neni 44)**. Zgjerimi i detyrimeve të autoriteteve është parashikuar edhe në drejtim të realizimit të fushatave të rregullta, në bashkëpunim me median, organet e barazisë dhe organizatat jo fitimprurëse. Theksi vihet tek ndërgjegjësimi për parandalim dhe raportim ndaj dhunës së lehtësuar nga teknologjia; kompetenca digjitale për prindërit dhe edukatorët mbi rreziqet online; fushata specifike për punëdhënësit/punëmarrësit mbi ngacmimin seksual në punë. Detyrimi për publikim të informacionit në gjuhë të thjeshtë dhe në formate për PAK jep garanci në lidhje me aksesueshmërinë e informacionit.

Trajnimi i profesionistëve (neni 45): Trajnimi i detyrueshëm për një gamë shumë më të gjerë profesionistësh se në ligjin aktual parashikohet jo vetëm për policinë, shërbimet sociale dhe gjyqësorin, por edhe për psikologët në shkolla, OJF, klinikat e ligjit, përmbaruesit, avokatët e ndihmës juridike, stafet arsimore, gazetarët dhe profesionistët e medias. Risi në këtë drejtim është përfshirja e gazetarëve dhe AMA-s për të luftuar stereotipet gjinore dhe fajësimin e viktimave në media.

Ligji parashikon një sistem të standardizuar dhe të bashkërenduar trajnimesh, të miratuara e përditësuara çdo vit. Përcaktohet bashkëpunimi i drejtpërdrejtë me ASPA, Shkollën e Magjistraturës, Akademinë e Sigurisë, KLGJ, KLP, ILD, AMA, Urdhrat Profesionale. Detyrimi për raportimin vjetor mbi trajnimin.

Pjesëmarrja e sektorit privat, medias dhe partive politike (neni 46): risi e projektligjit është vënia e theksit tek roli i sektorit privat, TIK-ut dhe medias në parandalimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, nëpërmjet nxitjes së standardeve vetërregulluese në media për respektimin e dinjitetit të grave si dhe përfshirjes së sektorit privat në edukimin e fëmijëve, prindërve dhe mësuesve mbi përmbajtjet e dëmshme online.

Risite kryesore të Kreut VIII – Autoritetet, koordinimi dhe bashkëpunimi

Autoritetet përgjegjëse (neni 47): përcakton se autoriteti kryesor përgjegjës për zbatimin e ligjit është ministria që mbulon çështjet sociale dhe të barazisë gjinore. Autoriteti kryesor përgjegjës ushtron rol drejtues, koordinues dhe monitorues në bashkërendim me autoritetet përgjegjëse të linjës: Të gjitha ministritë dhe institucionet e tjera të administratës publike në nivel qendror sipas kompetencave dhe fushës së përgjegjësisë dhe institucionet e tyre të varësisë; Njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe strukturat e tjera të përfshira në MKR si dhe me subjekte me rëndësi në zbatimin e këtij ligji janë: organizatat jofitimprurëse të cilat ushtrojnë veprimtari në fushën e luftës ndaj dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje; profesionet e lira dhe urdhrat e psikologut dhe të punojësit social, media dhe subjektet private sipas detyrave të përcaktuara për zbatimin e këtij ligji.

Përgjegjësitë e autoriteteve (neni 48): përcakton përgjegjësitë e autoriteteve qendrore e vendore për zbatimin e ligjit, duke përfshirë hartimin e politikave dhe procedurave të

integruara, koordinimin ndërinstitutional dhe marrjen e masave për mbrojtjen e viktimave edhe kur ato tërhiqen nga procesi. Autoritetet kanë detyrim të sigurojnë raportimin, informimin, referimin dhe shërbimet mbështetëse, si dhe të zhvillojnë fushata ndërgjegjëse e trajnime. Mosveprimi i tyre sjell përgjegjësi administrative, civile ose penale. Po ashtu, neni parashikon nxitjen e raportimit nga qytetarët e dëshmitarët duke garantuar anonimitetin, si dhe hartimin e udhëzuesve dhe politikave kundër dhunës, ngacmimit dhe sjelljeve që cenojnë dinjitetin në vendin e punës nga subjektet publike e private.

Detyrat e autoritetit kryesor përgjegjës (neni 49): i cili ushtron funksionin e autoritetit kombëtar për koordinimin dhe bashkërendimin ndërinstitutional dhe ushtron rol drejtues në hartimin, koordinimin dhe zbatimin e politikave të integruara, të programeve kombëtare dhe vlerëson burimet financiare dhe njerëzore të nevojshme për parandalimin, mbrojtjen e viktimave, llojshmërinë dhe cilësinë e shërbimeve mbështetëse të përgjithshme dhe të specializuara. Ky nen parashikon mbikëqyrjen e përmbushjes së detyrimeve nga autoritetet përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor për krijimin e strukturave të posaçme duke konsideruar parimin e përshtatjes së arsyeshme si dhe zbatimin programeve trajnuese të detyrueshme bazuar në politikat e miratuara, nevojat sipas sektorëve dhe të dhënave statistikore.

Detyrat e ministrive të linjës parashikohen nga neni 50 deri në nenin 54: konkretisht të Ministrisë për çështjet e rendit dhe sigurisë (**neni 50**), Ministrisë për çështjet e shëndetit (**neni 51**), Ministrisë për çështjet e drejtësisë (**neni 52**), Ministrisë për çështjet e arsimit (**neni 53**), Ministrisë për çështjet e punësimit (**neni 54**). Krahas ministrive të linjës ligji përcakton edhe detyrat e autoriteteve të informimit publik dhe medias (**neni 55**) dhe të Njësisë të Vetëqeverisjes vendore (**neni 56**).

Mbajtja, analizimi dhe publikimi i statistikave zyrtare (neni 57): autoriteti kryesor përgjegjës në bashkëpunim me INSTAT-in, mbledh, ruan, përpunon dhe publikon çdo vit të dhënat për dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje, në përputhje me ligjin për statistikat zyrtare, legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe metodologjitë e INSTAT-it. Statistikat vjetore publikohen brenda tremujorit të fundit të vitit pasardhës.

Kreu IX - DISPOZITA TË FUNDIT

Ligji nr. 9669/2006, “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar, i cili shfuqizohet me hyrjen në fuqi të këtij ligji.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Ngarkohet për zbatimin e këtij projektakti, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si dhe subjektet e tjera publike dhe private të përcaktuara në projektligj.

VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është hartuar dhe koordinuar nga MSHMS me kontributin e Grupit Teknik Ndërinstitutional të Punës, të ngritur me Urdhrin e ministrit nr.179, datë 30.04.2025 “Për

ngritjen dhe funksionimin e grupit teknik ndërinstitucional të punës për hartimin e ndryshimeve në Ligjin nr.9669, datë 18.12.2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar".

Grupi i Punës përbëhet nga përfaqësues të MSHMS (Zëvendësministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në cilësinë e kryetarit, si dhe anëtarët: Drejtori i Përgjithshëm i Zhvillimit të Mbrojtjes Sociale; Drejtori i Përgjithshëm i Politikave të Shëndetësisë; Drejtori i Barazisë Gjinore; Drejtori i Programimit, Harmonizimit, Kuadrit Rregullator; Drejtori i Politikave të Përkujdesjes Sociale dhe Shërbimeve Sociale të Integruara), si dhe përfaqësues nga: Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

Grupi i Punës realizoi disa takime, në bashkëpunim të ngushtë me ekspertet kombëtare (*Arta Mandro, Arjana Fullani, Mariana Semini, Iris Aliaj*) që u angazhuan nga UNDP dhe UN WOMEN për të lehtësuar procesin e hartimit të projektligjit. Në takimet e zhvilluara u identifikua paraprakisht nevoja e hartimit të ligjit të ri për parandalimin dhe mbrojtjen ndaj dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Mendimet e përcjella nga Grupi i Punës u pasqyruan pas çdo takimi konsultues në projektligjin e përgatitur.

Grupi i punës dhe ekspertet realizuan takim në datën 3 korrik 2025, si dhe takime konsultative me grupe të ndryshme interesi, si vijon:

- Me grupin e punës, nëpunësit gjinorë, përfaqësues nga Bashkia Tiranë (KVDHF Tiranë) - me datë 04.09.2025;
- Me 61 Koordinatorët Vendorë Kundër Dhunës në Familje - me datë 04.09.2025 (takim online);
- Me përfaqësues të shoqërisë civile, si: Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS), Qendra të Ndryshëm dhe të Barabartë (QDNJD), Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza (LKGv), Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim (GADC), GIZ Albania, NISMA ARSIS, VATRA, Instituti i Kulturës Rome në Shqipëri (IRCA), Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri (AWEN), Rrjeti i Barazisë në Vendimmarrje, Qendra Strehëza "Edlira Haxhiymeri", Qendra për Drejtësi Gjinore, Aleanca LGBTI, Forumi i Gruas Elbasan, Shoqata e Grave "Refleksione", Qendra Komunitare "Sot për të ardhmen", Shoqëria Kristiane e të Burgosurve të Shqipërisë (SHKBSH), Ambasada Suedeze, UNICEF, UN WOMEN, UNDP - me datë 09.09.2025. Organizatat u ftuan të përcillnin mendimet e tyre edhe me shkrim.
- Me institucionet e të drejtave të njeriut, si: Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Dhoma Kombëtare e Avokatëve, Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve, Avokatë ofrues të shërbimit ligjor falas, Urdhri i Psikologut, Urdhri i Punonjësve Socialë - me datë 09.09.2025;
- Me përfaqësues nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK), Policia e Shtetit-Drejtoria e Krimit Kibernetik, OJF e mediave, me datë 10.09.2025;
- Me përfaqësues nga Prokuroria e Përgjithshme, Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Gjyqtarë, Prokurorë, Përmbarues Gjyqësorë, Akademia e Sigurisë, Shkolla e Magjistraturës, me datë 10.09.2025.

Nga takimet konsultative të zhvilluara, u diskutua nevoja e hartimit të një ligji të ri.

Mendimet dhe sugjerimet e dërguara me shkrim nga grupet e interesit, institucione të tjera të përfshira në procesin konsultativ si dhe sugjerimet e marra nga konsultimi publik janë reflektuar në tekstin e projektiligjit.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Llogaritja e efektit financiar bazohet në analizën e bërë për kostimin e ligjit “Për Parandalimin dhe Mbrojtjen ndaj Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje”⁸. Shpenzimet për zbatimin e këtij projektiligji alokohen dhe përballohen nga disa institucione dhe programet buxhetore respektive të tyre. Në këtë analizë u vlerësuan shpenzimet vjetore për periudhën 10 vjeçare 2026-2035, në një format që mbështet dhe/ose orienton autoritetet përgjegjëse në planifikimin e buxhetit.

Efekti i përgjithshëm financiar është vlerësuar **2 014.1 milion lekë** i shpërndarë në dhjetë vite ose sa 7.3% e PBB së parashikuar për vitin 2026. Shumat sipas viteve në milionë lekë janë: (2026-148.7 milionë; 2027- 222.7 milionë; 2028- 322.7 milionë, 2029- 160 milionë, 2030- 260 milionë, 2031- 160 milionë, 2032- 160 milionë, 2033- 160 milionë, 2034- 160 milionë dhe 2035- 260 milionë). Pjesa tjetër e shpenzimeve mbulohet nga tavanet buxhetore të miratuara të autoriteteve përgjegjëse.

Më poshtë janë paraqitur shpenzimet vetëm për ato nene zbatimi i të cilave është vlerësuar që sjell efekte shtesë në buxhetin e autoriteteve përgjegjëse përtej përtej tavanëve buxhetore.

1. Fonde për miratimin e akteve nënligjore. Në disa nene të ligjit si (13, 15, 16, 17, 20, 21, 34, 54 dhe 52) parashikohet hartimi i procedurave, udhëzimeve, rregullore dhe VKM, të cilat duhet të miratohen 6 muaj pasi të jetë miratuar ligji. Shpenzimet të përlogaritura për të gjitha nenet e cituara janë rreth 126 milionë lekë dhe janë kosto për buxhetin vetëm një herë. Shpenzimet për këto nene janë për vitin 2026 dhe vlerësohen të mbuluara nga tavanet e miratuara të shpenzimeve buxhetore afatmesme për të gjitha autoritetet përgjegjëse.

2. Kostot financiare për aktivitetet që rrjedhin nga zbatimi i disa neneve të tjera të këtij projektiligji si nenet (19, 35, 36, 37, 38, 39, 40, 41, 42, 43, 44, 45, 48, 49, 50, 51 55, 56 dhe 57) mbulohen nga tavanet e miratuara të shpenzimeve buxhetore afatmesme të institucioneve përgjegjëse për zbatimin e projekt ligjit dhe nuk krijojnë efekte buxhetore shtesë.

3. Ndërgjegjësimi dhe edukimi publik Neni 46 i ligjit parashikon realizimin mbi baza vjetore të fushatave ose programe të rritjes së ndërgjegjësimit dhe edukimit të publikut. Zbatimi i këtij neni kërkon alokimin e fondeve të dedikuara për Autoritetin kryesor përgjegjës. Shuma e llogaritur është 20 milionë për çdo vit për periudhën 2026-2035 ose 200 milionë në total.

4. Trajnimi i profesionistëve - Viktimat e dhunës sipas këtij ligji trajtohen vetëm nga profesionistë të trajnuar dhe specializuar në këtë fushë. Ekspertiza, kualifikimi dhe format e trajnimit janë parashikuar në nenin 47. Miratimi i ligjit kërkon ofrimin e trajnimeve për të gjitha kategoritë e profesionistëve. Shpenzimet për trajnime janë vlerësuar vetëm për periudhën 2026-2028 dhe më pas Autoriteti kryesor përgjegjës dhe autoritetet e tjera duhet të mbështeten në

⁸ Analiza është bërë me mbështetjen ekspertëve të UN Women në tetor 2025

vlerësimin e nevojave për të parashikuar trajnimet.

Në total është parashikuar si shpenzim i ri shuma prej 8.1 milionë lekë ku përfshihet trajnimi i 300 profesionistëve çdo vit për periudhën 2026-2028. Në këtë shumë nuk janë përfshirë shpenzimet e planifikuara për trajnime mbi dhunën me bazë gjinore dhe dhunën në familje para hyrjes në fuqi të ligjit nga autoritete publike dhe private për periudhën 2026-2028.

5. Regjistrin Kombëtar i Dhunës Digjitale

Neni 23 parashikon krijimin e Regjistrin Kombëtar të Dhunës Digjitale. Efekti total për këtë projekt bazuar në projekte të ngjashme vlerësohet 120 milionë për periudhën 2027-2028. Kostot e mirëmbajtjes duhet të vlerësohen përpara futjes në përdorim nga autoriteti përgjegjës.

6. Efektet e ligjit për NJVV Disa nene përcaktojnë detyra për NJVV. Shpenzimet janë vlerësuar të mbuluara nga buxheti i NJVV (granti i pakushtëzuar dhe të ardhurat e veta) sipas legjislacionit në fuqi. Miratimi i këtij ligji krijon efekte financiare shtesë për ato njësi që nuk ofrojnë në territorin e tyre shërbimeve mbështetëse të përgjithshme dhe të specializuara. Njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet të parashikojnë fonde të nevojshme, në Fondin Social Lokal për ofrimin e këtyre shpenzimeve dhe sipas rastit mund dhe t'i bashkëfinancojnë këto shërbimeve. Shpenzimet për shërbime të reja (për të gjitha bashkitë nga të ardhurat e tyre) janë vlerësuar 40 milionë lekë në vit për periudhën 2027-2035 ose 360 milionë në total. Bashkëfinancimi nga Autoriteti kryesor përgjegjës për projektet e NJVV është vlerësuar 100 milionë çdo vit, për të gjithë periudhën 2026-2035.

7. Neni 59 ka parashikuar realizimin e **dy studimeve kombëtare** mbi prevalencën e të gjitha formave të dhunës. Studimet duhet të realizohen në çdo 5 vjet. Kostoja e studimit që duhet të realizohet nga INSTAT është vlerësuar 100 milionë për secilin studim, mbështetur në kostot e studimeve të ngjashme. Studimi i parë duhet të realizohet në vitin 2030.

PROPOZUESI

EVIS SALA

MINISTËR